

PLANI VJETOR I NDËRHRYJES

Emri i Projektit	Projekti 'Perspektiva të Reja' (PtR)
Plani Vjetor i Ndërhryjes (PVN)	PVN # 01-2023
Data e Shpalljes	14 gusht 2023
Data e Mbylljes së Aplikimeve	31 mars 2024
Pyetjet mbi këtë shpallje duhet të dorëzohen në këtë adresë elektronike jo më vonë se data e përcaktuar.	E-mail: np.grants@swisscontact.org 15 mars 2024

I. PËRSHKRIMI DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Projekti 'Perspektiva të Reja' (PtR) financohet nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe zbatohet nga Swisscontact, në konsorcium me TAG International. Projekti synon përmirësimin e kushteve kyçe socio-ekonomike që shpesh i shtyjnë njerëzit të migrojnë në mënyrë të parregullt në MB nga Veriu i Shqipërisë (Kukës, Has, Tropojë dhe Dibër). Projekti zgjat nga shtatori 2022 deri më 31 mars 2026. Mekanizmi i financimit të grantit të Perspektivave të Reja (PtR) është krijuar për të ndihmuar të rinjtë që kërkojnë të krijojnë mikro-biznesin e tyre, për të ndihmuar bizneset e NVM-ve me mundësi për të krijuar vende pune dhe të ardhura shtesë për njerëzit (kryesisht të rinj) dhe për të lehtësuar investimet në infrastrukturën strategjike ekonomike në sektorët dhe qendrat me mundësi të mëdha.

Projekti ndjek tre objektiva kryesore:

- rritjen e qëndrueshmërisë së komuniteteve ndaj presioneve për të emigruar në mënyrë të parregullt në MB;
- përmirësimi i kushteve dhe mundësive social-ekonomike në Qarkun e Kukësit dhe Bashkinë e Dibrës, veçanërisht për të rinjtë; dhe
- rritja e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve, sektorit privat dhe pushtetit vendor për zhvillimin ekonomik vendor.

Ky dokument përshkruan një mundësi për subjektet e kualifikuara për të aplikuar për grante për të kryer aktivitete që mbështesin sipërmarrjen, punësimin dhe zhvillimin e biznesit të Qarkut të Kukësit dhe Bashkisë së Dibrës në fushat specifike të mëposhtme:

Aktivitetet e financuara nga granti i projektit PtR do të realizohen në qarqet Kukës dhe Dibër, përkatësisht në Bashkitë Kukës, Has, Tropojë dhe Dibër.

Aktivitetet e Kualifikuara të PtR:

Projekti nxit aplikimet nga të gjithë individët që propozojnë krijimin e një kompanie/ sipërmarrje, mikro-bizneset, NVM-të dhe PPP-të nga grupe ose organizata që kontribuojnë në objektivat e projektit dhe çojnë në rritjen e punësimit në Qarkun e Kukësit dhe Bashkinë e Dibrës. Më poshtë është lista e aplikantëve të kualifikuar, por pa u kufizuar, që mund të aplikojnë për grant:

- Mikro-bizneset (mundësisht ata që kanë përfunduar ciklet C4EE, ciklet e mentorimit të mikro-biznesit ose kampet verore të sipërmarrjes rinore)
- Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (mundësisht ato që kanë mundësi për të krijuar punësim direkt ose indirekt)
- Ndërmarrjet e përbashkëta PPP (mundësisht ato që drejtohen nga palë private)
- Ofruesit e shërbimeve që ju qasen kufizimeve në sektorët me prioritet ekonomik
- Organizatat e biznesit dhe profesionistëve që ju qasen kufizimeve në sektorët me prioritet ekonomik

Aktivitetet e grantit të projektit do të kryhen në bashkëpunim me partnerët e projektit si komuniteti vendor i mikro-biznesit dhe NVM-të, komuniteti i biznesit të NVM-ve nga diaspora apo migrantët, institucionet mikro-financiare dhe bankare dhe bashkë-investitorët, PPP-të e krijuara për të menaxhuar infrastrukturën strategjike ekonomike në sektorët dhe qendrat ekonomike me mundësi të mëdha, qeveritë vendore, OJQ-të dhe ofruesit e shërbimeve shtetërore.

Plani Vjetor i Ndërhyrjes PtR (PVN)

Projekti PtR do të përdorë procesin e Planit Vjetor të Ndërhyrjes (PVN) për të kërkuar aplikime që kontribuojnë drejt objektivave të projektit.

Projekti PtR nxit aplikimet nga të gjithë individët që propozojnë krijimin e një kompani/ sipërmarrje, mikro-bizneset, NVM-të dhe PPP-të nga grupe ose organizata që kontribuojnë drejt objektivave të projektit dhe çojnë në rritjen e punësimit dhe të ardhurave dhe jetesën e mirë në Qarkun e Kukësit dhe Bashkinë e Dibrës. Përparësi e madhe u jepet nismave që shfrytëzojnë mundësitë ose heqin kufizimet në sektorët dhe qendrat e përzgjedhura me ndikim/mundësi të madhë. Propozimet e biznesit duhet t'ju qasen të paktën një ose shumë sfida që mbizotërojnë në sektorët ose funksionet ndërsektoriale më poshtë.

Modelet/idetë e propozuara të biznesit duhet t'i përmbahen dhe mbështesin një ose më shumë nga sektorët me mundësi të mëdha si më poshtë:

- Turizmi.
- Bimët medicinale dhe aromatike (BMA)
- Përpunimi vendor i mishit dhe djathit
- Produkte pyjore jo drusore (PPJD)
- Sektori i shërbimeve ndërsektoriale të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Më tej, projekti do t'i kushtojë vëmendje të veçantë qendrave të mëposhtme të mundësive ekonomike:

- Valbona (si destinacion turistik)
- Aeroporti i Kukësit
- Produktet e certifikuara bujqësore dhe blegtorale të Hasit, Tropojës, Kukësit dhe Dibrës
- Shishtavec (si destinacion turistik i sporteve dimërore)
- Tunelet e Kukësit (si destinacion turistik)

Çfarë ofron PtR

Projekti PtR mund të ofrojë mbështetje teknike dhe financiare për të zbatuar modelet/idetë e biznesit të propozuar dhe të miratuara:

- Marrëveshje të mbështetjes financiare, me kontribut nga PtR me vlerë treguese **500,000 lekë** për krijimin e mikro-bizneseve^{1 2}; dhe me vlerë treguese **2,500,000 Lekë** për NVM-të³ ose PPP-të⁴. Marrëveshja përfundimtare do të negociohet me kompanitë e përzgjedhura dhe të kualifikuara. Kjo mbështetje duhet të kontribuojë në një investim të rëndësishëm që kompanitë do ta bëjnë vetë.
- Ndihmë në rregullimin/përmirësimin e modeleve të propozuara të biznesit ose planeve strategjike.
- Mbështetje teknike sipas nevojës për zbatimin e suksesshëm të modeleve/nismave të propozuara.

PtR gjithashtu mund të ofrojë ndjekje dhe mbështetje të afërt të grantit dhe/ose për përfituesin e grantit për të rritur ndërhyrjet e suksesshme.

¹ Mikro-bizneset: më pak se 5 punonjës me kohë ekuivalent të plotë dhe qarkullim vjetor më pak se 5,000,000 lekë.

² Përfshihen mikro-bizneset formale dhe joformale.

³ NVM-të: 5 ose më shumë punonjës me kohë ekuivalent të plotë, ose qarkullim vjetor 5,000,000 lekë ose më shumë.

⁴ Përfshihen PPP-të formale ose joformale, të bazuara ose jo në ligjin për PPP-të.

Fondi PtR nuk mund të përdoret për:

- Aktivitete që mund të çojnë në trazira civile
- Aktivitetet që diskriminojnë ndaj çdo grupi në bazë të moshës, ndryshimit të gjinisë, paaftësisë, racës, ngjyrës, përkatësisë etnike, seksit dhe orientimit seksual, shtatzënisë dhe amësisë, fesë ose besimit
- Dhuratat
- Gjobat ligjore, gjobat penale, dënimet dhe kostot ligjore të lidhura me to
- Pagesat për punë ose aktivitete që financohen plotësisht nga burime të tjera qoftë në para apo në natyrë
- Veprimtaritë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së për Ndihmën Shtetërore
- Borxhet e këqija ndaj palëve të lidhura
- Pagesat për largimin e padrejtë nga puna dhe kostot ligjore të lidhura me to
- Zëvendësimi ose rimbursimi i çdo fondi të humbur nga mashtrimi, korrupsioni, ryshfeti, vjedhja, financimi i terrorizmit ose keqpërdorim tjetër i fondeve
- Fonde rezervë ndaj inflacionit ose këmbimit valutor
- Polica sigurimi për fonde rezervë ose rreziku
- Kostot e ndodhura përpara se të hyjë në fuqi një marrëveshje zyrtare, duke përfshirë ato që lidhen me përgatitjen e propozimeve për oferta ose grante

Rezultatet e pritura

Pritet që kompanitë/firmat pjesëmarrëse të kontribuojnë drejtpërdrejt në punësime të reja, rritjen/krijimin e biznesit dhe të ardhurat totale të krijuara shtesë, nisma që shfrytëzojnë mundësitë ose heqin kufizimet në sektorët dhe qendrat e përzgjedhura me ndikim/mundësi të mëdha. Në varësi të suksesit që do ketë partneriteti fillestar, do të ketë mundësi për investime shtesë për të rritur më tej modelet e suksesshme.

II. INFORMACION PËR GRANTIN

Vlerat që mund të shfaqen më poshtë janë parashikime treguese. Aplikantët nuk duhet t'i përdorin ato si objektiva ose të mendojnë se ato janë vlera të garantuara.

Numri i parashikuar i granteve që do të jepen	15 NVM-ë/PPP-ë 150 Mikro-biznese
Vlera e parashikuar e një granti individual, që nuk duhet të tejkalohet	500,000 lekë për çdo Mikro-biznes 2,500,000 lekë për çdo NVM-ë/PPP-ë
Monedha në të cilën do të jepet dhe paguhet granti	Lekë Shqiptare
Periudha e parashikuar e zbatimit të një granti individual (kohëzgjatja në muaj)	Deri në 12 muaj.
Data e parashikuar e fillimit të zbatimit (Shënim: Grantet nuk pritet të fillojnë të gjithë në të njëjtën datë. Kjo datë është vetëm një tregues se kur pritet të fillojë grupi i parë i granteve.)	Nga 01 shtator 2023 deri më 31 mars 2024
<p>Lloji i grantit që mund të jepet: (Shënim: Zgjedhja përfundimtare e instrumentit të grantit do të përcaktohet pasi të jenë vlerësuar të gjithë elementët e aplikimit për grant, duke përfshirë çdo rrezik që mund të identifikohet nga projekti PtR.)</p> <p><input checked="" type="checkbox"/> Grant në natyrë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vetëm mallrat dhe shërbimet (jo para në dorë) do të transferohen tek përfituesi i grantit. <p><input checked="" type="checkbox"/> Granti me shumë fikse</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfituesi i grantit do të marrë fondet e grantit në disa pagesa të paracaktuara të vlerës fikse (të pandrysheshme) vetëm pas përfundimit të suksesshëm të objektivave të piketuara që do jenë të matshme ose të verifikueshme. 	

III. KUALIFIKIMI I APLIKANTËVE TË MUNDSHËM

Projekti PtR nxit aplikime nga të gjithë individët që propozojnë krijimin e një kompanie /sipërmarrje, mikro-bizneset, NVM-të dhe PPP-të nga grupe ose organizata që kontribuojnë drejt objektivave të projektit.

Të gjithë aplikantët duhet të jenë në gjendje të vërtetojnë se plotësojnë kërkesat e mëposhtme të detyrueshme të kualifikimit.

1. Propozoni aktivitete që do zbatohen në qarkun e Kukësit dhe bashkinë e Dibrës të përcaktuar si rajoni i synuar i projektit PtR, në sektorët ose qendrat e identifikuara me ndikim/mundësi të mëdha.
2. Të jenë persona me dokumentacion ose subjekte të regjistruara ligjërisht në Shqipëri (kërkuesi duhet të paraqesë dokumente regjistrimi ose dëshmi të përkatësisë në një organizatë të regjistruar);
3. Të vërtetojnë aftësinë për të menaxhuar fondet (dëshmi të sistemeve të llogarimbajtjes financiare, mbajtjen e shënimeve të sakta dhe të detajuara të të gjitha shpenzimeve dhe të ketë personel të caktuar për menaxhimin financiar); dhe
4. Të mos jetë në asnjë listë të palëve të shpallura të dënuara nga; ose aktualisht i përjashtuar ose i skualifikuar nga pjesëmarrja në këtë transaksion nga Ministria e Financave e HM, Ministria e Brendshme e Mbretërisë së Bashkuar, Bashkimi Evropian, Kombet e Bashkuara, Banka Botërore, qeveri të tjera kombëtare ose organizata publike ndërkombëtare.
5. Janë dakort që t'i nënshtrohen një vlerësimi para dhënies së grantit për të shqyrtuar zotësinë ose aftësinë e tij për të pasur kompetencën e nevojshme menaxheriale për të planifikuar dhe kryer aktivitetet që do të financohen, dhe që aplikanti do të praktikojë metodat e menaxhimit të përgjegjshëm të fondeve dhe mjeteve të tjera që do të jepen në kuadër të grantit, për të cilat është rënë dakord bashkarisht.
6. Të gjithë përfituesit e Grantit, duhet të zbatojnë Rregullat e Kornizës Operative (PrOF) dhe manualin e operacioneve të SC, të cilat ofrojnë detaje të mëtejshme se si mund dhe nuk mund të shpenzohen fondet. Në rast dyshimi, partneri ose furnitori i mundshëm duhet të konsultohet paraprakisht me SC dhe FCDO. Rregullat e FCDO PrOF gjenden në internet në: <https://www.gov.uk/government/publications/fcdo-programme-operating-framework>

Kërkesat shtesë të kualifikimit:

- Duhet të bëni vetë, një bashkë-financimit të investimit prej të paktën 20% për krijimin e mikro-bizneseve⁵ ⁶; dhe 50% (40% në rast se plani i biznesit ndikon mbi 60% në punësime të reja të grave) për NVM-të⁷ dhe PPP-të⁸ e reja ose ato ekzistuese, të buxhetit total të propozuar. Përfituesi i grantit nxitet që të sigurojë më shumë se përqindja minimale e kërkuar në varësi të nivelit të intensitetit të mbështetjes së kërkuar.
- Nuk është i përfshirë në një aktivitet të ndaluar nga Qeveria e MB dhe nuk ka mospagesa ndaj ndonjë projekti zhvillimi.
- Do tu jepet përparësi, modeleve/ideve të biznesit të propozuara që i përmbahen dhe mbështetin një ose më shumë nga sa vijon – (i) kontribuon drejtpërdrejt në punësime të reja, (ii) rritjen/krijimin e biznesit dhe të ardhurat totale të gjeneruara shtesë (iii) nismat që shfrytëzojnë mundësitë ose heqin kufizimet në sektorët dhe qendrat e përzgjedhura me ndikim/mundësi të mëdha.
- Dokumentet ligjore mbështetëse (p.sh., certifikatë e regjistrimi, liçensë tregtimi, NIPT, vërtetimi i llogarisë bankare dhe/ose çdo dokument tjetër ligjor që mund të konsiderohet i nevojshëm sipas rregullit të vendit dhe kërkesave të PtR) duhet të dorëzohen si pjesë e një procesi verifikimi.

⁵ Mikro-bizneset: më pak se 5 punonjës me kohë ekuivalent të plotë dhe qarkullim vjetor më pak se 5,000,000 lekë.

⁶ Përfshihen mikro-bizneset formale dhe joformale.

⁷ NVM-të: 5 ose më shumë punonjës me kohë ekuivalent të plotë, ose qarkullim vjetor 5,000,000 lekë ose më shumë.

⁸ Përfshihen PPP-të formale ose joformale, të bazuara ose jo në ligjin për PPP-të.

IV. INFORMACION PËR APLIKIMIN DHE DORËZIMIN

A. *Formati*

1. Të gjitha kostot që lidhen me aplikimin ndaj kësaj shpallje do të jenë përgjegjësi vetëm e secilit aplikant.
2. Projekti PtF rezervon të drejtën të mos japë asnjë grant nga kjo shpallje.
3. Aplikantët duhet të përdorin modelin e dhënë në Shtojcën A për qasjen teknike dhe buxhetin përkatës.
4. Aplikimet duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe.
5. Numri i përgjithshëm i faqeve për qasjen teknike nuk duhet mbi 5 faqe, duke përfshirë dokumentat bashkëngjitur që mbështesin seksionin teknik.
6. Aplikimet elektronike do të pranohen deri në datën e mbylljes. Nëse dorëzohet në mënyrë elektronike, pjesa teknike dhe çdo dokument bashkëngjitur duhet të dorëzohet duke përdorur Microsoft Office Word.

Aplikimet elektronik duhet të dorëzohet në këtë adresë e-mail: np.grants@swisscontact.org duke theksuar qartë "Aplikim në përgjigje të PVN # 01-2023" tek subjekti.

PtF nuk është përgjegjëse për mos dërgimin me sukses nga aplikanti.

B. *Udhëzime shtesë për seksionin teknik*

Aplikantët duhet të propozojnë aktivitete që janë të orientuara drejt rezultateve për të ndihmuar në arritjen e objektivave të përshkruara në seksionin I, Përshkrimi i Projektit. Rezultati është një ndryshim i rëndësishëm, i synuar dhe i matshëm në gjendjen e një përfituesi ose një ndryshim në vend, institucionet ose subjektet e tjera që do të ndikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi tek përfituesi. Aplikimi duhet të tregojë se aplikanti i kupton mirë këto objektiva duke propozuar arritjen e rezultateve sasiore që mund të maten.

Një aplikim për grant i orientuar drejt rezultateve duhet të ketë së paku tre elementët kryesorë të mëposhtëm:

- Përcakton rezultatet specifike që duhen arritur dhe strategjitë dhe proceset e identifikueshme për t'u arritur rezultatet e synuar.
- Sistemi i menaxhimit të performancës të masë dhe vlerësoj arritjet e rezultatet e planifikuara. Kjo do të përfshijë të dhënat bazë dhe objektivat e zbatimit në nivele të ndryshme me të cilat mund të krahasohen arritjet aktuale.
- Përgjegjësia për performancën për të përcaktuar se kush është përgjegjës për arritjen e rezultateve.

C. *Udhëzime shtesë për Seksionin e Buxhetit*

1. Aplikantët duhet të propozojnë vetëm ato shpenzime që janë të nevojshme dhe të arsyeshme për të kryer aktivitetet e përshkruara në aplikim. Udhëzimet për kufizime të caktuara jepen në Seksionin II, Informacioni për Grantin.
2. Shpenzimet do të shqyrtohen bazuar tek standardet e parimit të kostos.
3. Aplikantëve u kërkohet të paraqesin një përshkrim të buxhetit që shpjegon dhe justifikon nevojën përshpenzimet e propozuara në buxhet. Përshkrimi duhet të ndihmojë vlerësuesin të kuptojë ***pse një zë i shpenzimeve është i nevojshëm dhe si do të përdoret për aktivitetin për të cilin do të kryhet***. Përshkrimi i buxhetit duhet të përcaktoj lidhjen ndërmjet aktiviteteve të propozuara dhe buxhetit. Njësoj si aplikimi teknik duhet të pasqyrojë të kuptuarit e aplikantit për objektivat dhe qasjen e propozuar për arritjen e atyre objektivave, buxheti dhe përshkrimi shoqërues duhet të jenë realist dhe të tregojnë një kuptim të ngjashëm të kërkesave financiare të programit të propozuar të aktiviteteve.

V. PROCESI I VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES

Projekti do të krijoj një Panel të Vlerësimit të Granteve (PVG) që do të vlerësojë Aplikimet e paraqitura në përgjigje të kësaj PVN-je në baza të përhershme. Aplikimet do të vlerësohen bazuar në Kriteret e Vlerësimit të përfshira në Seksionin VI më poshtë. Kjo shpallje do të përfshijë fazat e mëposhtme të procesit të dorëzimit dhe vlerësimit të aplikimeve:

Dorëzimi i Aplikimit: Aplikantëve u kërkohet të dorëzojnë propozimet e tyre duke përdorur Formularin e Aplikimit të përfshirë në Shtojcën A të kësaj PVN-je. Projekti nxit aplikantët që të dorëzojnë aplikimet e tyre në çdo kohë përpara datës së mbylljes së këtij PVN-je, në mënyrë elektronike, me email në np.grants@swisscontact.org duke theksuar qartë "Aplikimin në përgjigje të PVN # 01-2023" në rreshtin e temës. Aplikimi i dorëzuar pas kësaj date nuk do të merret parasysh sipas këtij PVN.

Vlerësimi fillestar: Projekti fillimisht do të shqyrtojë të gjitha aplikimet nëse janë të plotë, përmbushin kriteret minimale dhe përputhen me objektivat e PVN-së. Aplikimet që vlerësohen me 70 pikë e lart, do të kualifikohen për fazën tjetër të procesit të vlerësimit të grantit. Njoftimi për rezultatin e Vlerësimit Fillestar do t'u dërgohet aplikantëve të pasuksesshëm ose të papërshtatshëm jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të Vlerësimit Fillestar.

Procesi i verifikimit dhe bashkë-krijimi: Në këtë fazë, projekti do të kryejë një sërë aktivitete për të vlerësuar më thellë nëse aktiviteti i propozuar i grantit përputhet me objektivat e projektit dhe kriteret e përzgjedhjes.

verifikimi mund të përfshijë sqarimin e pyetjeve vijuese përmes emailit ose telefonit, kryerjen e intervistave, vizitat në terren, kërkim mbi historikun, kontaktimin e referencave dhe/ose kërkimin e materialeve shtesë që përvijojnë më tej qasjen teknike të aplikantit dhe përputhjen e saj ndaj parimeve thembësore dhe kriterëve të përzgjedhjes së Projektit.

Projekti mund të angazhohet në bashkë-krijim me aplikantin dhe ruan të drejtën për të rritur ose ulur vlerën e financimit, për të ndryshuar objektin e një aplikimi, për të ndryshuar aktivitetet e propozuara dhe mund të kërkojë një aplikim/plan biznesi të ri ose të përditësuar dhe dokumente shtesë mbështetëse. Pavarësisht nga vendimi i financimit, Projekti mund t'i prezantojë aplikantët me partnerë ose investitorë të tjerë të mundshëm, ose me burime të tjera financimi që mund të kontribuojnë në aktivitet. Përfshirja e partnerëve shtesë do të ndodhë vetëm kur ka kuptim teknik dhe kur ka një marrëveshje për të përfshirë partnerë shtesë midis aplikantit dhe Projektit. Projekti do të njoftojë aplikantin për bashkë-krijimin dhe do të caktojë afatin kohor për çdo takim dhe/ose seminar.

Vlerësimi përfundimtar: Pas fazës së verifikimit dhe bashkë-krijimit dhe rezultateve të saj, aplikimi/plani i biznesit përfundimtar për grante i përpunuar/përditësuar do të rishikohet nga PVG. Bazuar në kriteret e vlerësimit të përshkruara në Seksionin VI më poshtë, Paneli do të vlerësojë aplikimet dhe do të përzgjedhë aplikimet për financim. Vetëm aplikimet që marrin më shumë se 70 pikë do të kualifikohen për negociata të mëtejshme. Pasi të përfundojnë negociatat, Projekti do të finalizojë dhënien e grantit/marrëveshjen e partneritetit me përfituesin/partnerin e përzgjedhur.

VI. KRITERET E VLERËSIMIT

Aplikimet do të vlerësohen sipas kriterëve të vlerësimit në tabelën e mëposhtme.

Kriteret	Rezultati Maksimal
Cilësia dhe fizibiliteti teknik	60
Kapaciteti organizativ dhe Performanca e kaluar	25
Efektiviteti dhe realizmi i shpenzimeve	15
Total:	100

Këto elemente të kriterëve të vlerësimit përshkruhen më gjerësisht më poshtë.

A. Cilësia dhe fizibiliteti teknik: Cilësia dhe fizibiliteti i aplikimit për sa i përket zbatueshmërisë së qasjes teknike të propozuar, (dmth., qasja teknike e propozuar, arsyeshëm pritët që të prodhojë rezultatet e synuara), sa e përshtatshme është metodologjia e propozuar, risia, dhe plani i punës për realizimin e projektit. Vlerësimi i qasjeve mund të përfshijë ose qasje të provuara që janë efektive ose qasje të reja të paprovuara për që janë premtuese. Gjithashtu do të vlerësohen mekanizmat e propozuar për monitorim e vlerësim me tregues objektivisht të matshëm. **60 pikë**

B. Kapaciteti organizativ: Dëshmon aftësi për të ndërmarrë dhe realizuar aktivitetet e propozuara dhe për të forcuar pozitivisht mjedisin ekonomik dhe investues. Aplikimi duhet të tregojë efektivitetin e organizatës për sa i përket strukturës së brendshme, kapacitetit teknik dhe personelit kryesor, në përbushjen e objektivave të zhvillimit ekonomik. Përveç kësaj, organizata duhet të dëshmojë aftësi të përshtatshme të menaxhimit financiar. Vlerësimi do të bazohet kryesisht mbi profilin, historikun, kualifikimet, reputacionin, përshtatshmërinë dhe aftësitë e personelit të tij kryesor; dhe "arritjet në të kaluarën", reputacioni dhe arritjet (duke përfshirë zhvillimin e aktiviteteve të vetë-mjaftueshme dhe të qëndrueshme) të organizatës. **Performanca e kaluar:** Përvoja e mëparshme ose e vazhdueshme në zbatimin e aktiviteteve të ngjashme. Kjo shqyrton referencat dhe përvojën e një aplikanti, i cili është një faktor kritik në vlerësimin e kapacitetit të organizatës për të zbatuar aktivitetin. **25 pikë**

C. Efektiviteti dhe realizimi i shpenzimeve: Shkalla në të cilën buxheti është i qartë dhe i arsyeshëm dhe pasqyron përdorimin më të mirë të burimeve organizative dhe të granteve. Kontributi i aplikantit pasqyron përkushtimin ndaj projektit. Çdo aplikant që të mbështetet nën këtë PVN duhet të bëjë vetë një bashkë-financim të investimit prej të paktën 20% për krijimin e mikro-bizneseve; dhe 50% (40% në rast se plani i biznesit ndikon mbi 60% në punësime të reja të grave) për NVM-të dhe PPP-të e reja ose ato ekzistuese, të buxhetit total të propozuar drejt zbatimit të veprimtarisë. **15 pikë**

Për më tepër, projekti PtF do të sigurojë qëndrueshmërinë mjedisore dhe pajtueshmëri, në projektim dhe zbatim sipas nevojës.

VII. INFORMACION PËR MARRËVESHJEN DHE ADMINISTRIMIN

Të gjitha grantet do të negocohen, përcaktohen dhe financohen në *Lekë Shqiptare*.

Të gjitha shpenzimet e financuara nga granti duhet të jenë të lejueshme, të përcaktuara dhe të arsyeshme. Aplikimet për grante duhet të mbështeten nga një buxhet i detajuar dhe realist siç përshkruhet në Seksionin IV.

Shpallja e kësaj PVN-je dhe ndihma për zhvillimin e aplikimit nuk përbëjnë një marrëveshje apo angazhim nga ana e projektit PtF dhe as nuk e angazhon projektin PtF të paguajë për shpenzimet e bëra për përgatitjen dhe dorëzimin e një aplikimi. Më tej, projekti PtF rezervon të drejtën të pranojë ose refuzojë çdo ose të gjitha aplikimet e dorëzuara. Aplikantët do të informohen me shkrim për vendimin e marrë në lidhje me aplikimin e tyre.

Aneksi A – Formulari i Aplikimit dhe i Buxhetit